



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Barrierash” (*Procedure e hapur e thjeshtuar - Mall*)

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Barriera sigurie 34928310 - 4
- Trarë 44212240 - 3

Afati i lëvrimit të mallrave do të jetë **60 (gjashtëdhjetë) ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës, dhe kjo është kontratë furnizim vendosje.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – Autoriteti Portual Durrës – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*sipas shtojcës 8*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përlogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë personel të kualifikuar për realizimin e projektit.

Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën e kërkuara për :

- **ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente** për menaxhimin e cilësive

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, të ndryshuar secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrin përsipër të realizojnë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

2.3.3 Për listën e mallrave/materialeve të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara.

2.3.4 Për materialet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen.

2.3.5 Operoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar ne SPE nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës.Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit.Adresa dhe web-sit të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.
- c. Nr.i faqes në katalog referuar Nr.Idetifikues te artikullit të ofruar sipas listës i shenuar me nje shenje dalluse.